

Република Северна Македонија
ОПШТИНА ЖЕЛИНО
Ж Е Л И Н О



Republika e Maqedonisë së Veriut
KOMUNA E ZHELINËS
Z H E L I N Ë

PROPOZIM-PROGRAM

(Për rregullimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore, aktiviteteve shkollore dhe jashta mësimore në shkollat fillore të komunës së Zhelinës për vitin 2021)

Përgatiti: Saubi Avziu

Lazim Idrizi

Zhelinë

Dhjetor, 2020.

PROPOZUESI

KRYETARI

Blerim Sejdiu

PROGRAM

(Për investime në vitin 2021 të parapara me buxhetin e komunës)

Edhe pse fillimi i vitit 2020 ishte, dhe do të mbetet një ndër vitet më të mbrapshta gjatë tërë jetës në çdo pikëpamje të jetës sikurse edhe në organizimin e jetës arsimore, e kjo ndodh për shkak të përhapjes së Pandemisë **Covid-19** nga OBSH-ja. Sëmundje kjo, që shkaktoi katrahurë të jashtëzakonshme madje edhe viktima në njerës si në mbarë botën poashtu edhe tek ne. Kjo Pandemi si duket ka ndryshuar rendin e ri botëror në çdo pikëpamje të jetës si në punë, shkollë, familje, shoqëri etj.

Ky problem botëror shkaktoi vështirështirësi edhe në shumë planifikime tjera të parapara që më herët, e një ndër ta edhe në planifikimet tona në rregullimin e mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore. Shumë aktivitete nuk u realizuan në kohën e paraparë dhe me dinamikën e paraparë, por krejt në fund ata u realizuan për aq sa edhe koha dhe kushtet premtuan.

Nën ethet e kësaj Pandemie **Covid-19** si duket dhe ky vit do të kaloj, sipas parashikimeve të OBSH-së deri në gjetjen dhe zbulimin e një vaccine kundër kësaj Pandemie.

Në organizimin e jetës edukativo-arsimore, ky fillim viti shkollor 2020/2021, na zuri përsëri nën ethet dhe frikën e përhapjes së Virusit Covid-19. Të gjitha shkollat filluan me një muaj vonesë me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të komisionit shëndetësor. Edhe pse me vonesë përsëri mësimi filloi të realizohet nga largësia që akoma dhe vazhdon të realizohet me mjaftë vështirësi. Mësimi me presencë fizike zhvillohet vetëm në ciklin e ulët edhe pse në kohë u përcollën vendimet dhe kërkesat e shkollave për marrje të pëlqimit për realizimin e procesit edukativo-arsimor me presencë fizike, e njëjta nuk u aprovua nga komisioni amë për dhënien e pëlqimit si në shumë shkolla tjera të RMV-së.

Komuna e Zhelinës në kuadër të mundësive të saja dhe falë donatorve lokal nga biznesmen dhe afarist të vendit për të gjitha shollat e komunës së Zhelinës u dhuroi material higjienike dhe dezinfektuese për objektet shkollore dhe nxënësit, mjete vizuele dhe audio-vizuele kompjutor dhe mjete tjera për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor.

Edhe pse në kushte të tilla me të cilart ballafaqohet, jo vetëm vendi ynë, por e tërë bota. Komuna e Zhelinës edhe për këtë vit do të ndërmer masa dhe hapa konkret në përmirësimin e kushteve në rregullimin dhe meremetimin e infrastrukturës së objekteve shkollore për vitin 2021.

Në kornizë ju paraqesim të dhënat e parashikimeve buxhetore për veprimtaritë që do të duhet të realizohen në vitin **2021**. Të dhënat e paraqitura në tabelarë janë pjesë e programës së komunës së Zhelinës, si nevojë për përmirësimin e kushteve në arsim respektivisht kushteve nëpër shkollat fillore për zhvillimin normal të procesit edukativo-arsimor.

Emri i shkollës	Shpenzime të parapara 2020/21	Lloji i investimit
<i>Sh.f''Fan Noli''f.Pallaticë</i>	-sipas të dhënave të projektit =695.800,00 den)	<i>Rekonstruimi i nyjeve sanitare të objektit të shkollës.</i>
<i>Sh.f''Fan Noli''f.Trebosh</i>	-Sipas te dhenave nga projekti =8.671,942.53	<i>Rikonstruim i objektit të shkollës,(kulmi,dritaret efikasiteti energjetik)</i>
<i>Sh.f''Pashko Vasa''f.Grupçin</i>	-sipas të dhënave të projektit në përpilim	<i>-Projektimi i një çerdhe për fëmijë.</i>
<i>Sh.f''Rametulla Ameti''f.Çiflik</i>	-Sipas Paralogarisë së projektit.	<i>-Rrethoja e fushës së sportit.</i>
<i>Në të gjitha shkollat fillore qendrore dhe periferike të komunës së Zhelinës.(Nga buxheti i komunës dhe donacione te ndryshme)</i> <i>Ngritja e një shtëpie kulture me karakter komunal.</i>		<i>Ngritja e këndeve për lojra për fëmijë në të gjitha shkollat qendrore dhe periferike ku ka hapësira të mjaftueshme.(Buxheti I komunës dhe donator tjerë.</i> <i>Projekti dhe dokumentacioni teknik.</i>

<i>Sh.f''Luigj Gurakuqi''f.Leshnicë</i>	-Sipas paralogarisë së	<i>-Projekti i instalimit të</i>
---	------------------------	----------------------------------

epërme	projektit. =221.500.00.den)	nxemjes qendrore.
Sh.f"Luigj Gurakuqi" f.Leshnicë e poshtme	-Sipas paralogarisë së projektit. =6.273.000.00.den	Ndërtimi i objektit të shkollës fillore.

Në kuadër të kësaj programe investive, Komuna e Zhelinës dhe autoritetet tjera kanë hartuar edhe projekte të tjera për përmirësimin e kushteve në arsim, në mënyrë të rregullt punohet në gjetjen e mundësive financiare për realizimin e tyre, dhe do të përkrahen të gjitha ata projekte të cilat do të gjejnë interesimin e donatorëve të jashtëm. Si projekte të cilat janë finalizuar dhe që pritet mbështetja e tyre financiare janë me sa vijon:

Sh.f."Pashko Vasa" f.Dobërcë	-Sipas paralogarisë së projektit në përgatitje.	-Instalimi shtesë i radiatorve në objektin e shkollës.
Sh.f" Pashko Vasa" f.Cerovë	-Sipas paralogarisë së projektit. Tot: =10.997.295 den. =6.647.955 den B.Botërore. =4.349.340 den.kof.Komuna.	-Ndërtimi i objektit të ri të shkollës.
Sh.f" Pashko Vasa" f.Grupçin	-Sipas paralogarisë së projektit në përpilim	-Projektimi i një salle sportive për nxënës dhe të rinj.

<i>saj.</i>		
<i>-Mbështetja financiare e organizimit të kampingut dhe adhuruesve të natyrës(Alpinistëve) të rinjë.</i>	<i>25.000.den.</i>	<i>Maj-Qershor</i>
<i>-Përkrahje rreth organizimit dhe realizimit të turnireve shkollore në nivel komunal.</i>	<i>10.000 den.</i>	<i>Maj-Qershor</i>
<i>-Akademi solemne për figurat e shquara historike.</i>	<i>10.000 den.</i>	<i>Sipas nevojës.</i>
<i>-Stimulim i figurave për kontributin e dhënë në veprimtarinë e tyre në ngritjen e vetëdijes tek brezat e rinj.</i>	<i>10.000 den.</i>	<i>Sipas nevojës.</i>
<i>-Donacione tjera për shkollat me interes për nxënësit dhe kuadrin.</i>	<i>30.000 den.</i>	<i>Sipas nevojës.</i>

GJITHËSEJ : **270.000 den.**

Në vazhden e këtyre parashikimeve, në buxhetin e komunës së Zhelinës janë të parapara edhe mjete të tjera financiare për punë të kryera e që pritet së shpejti të kryhen,si rrjedhojë e aktiviteteve që pasojnë nga faza e parë e realizimit të punëve ndërtimore nga viti 2020/21.

Obligimet e mbetura nga viti paraprak do të barten për vitin 2021.

Këshilli i Komunës së Zhelinës

Nr.08- _____

Kryetari

_____ vit

Liridon Useini

Zhelinë

- Për hartimin e kësajë Propozim-Programme u shfrytëzuan burime nga:
- Të dhëna mbi gjendjen fizike të shkollave fillore.
- Të dhënat elementare të shkollave fillore të komunës.
- Ndjekja permanente e veprimtarisë së shkollave fillore në nivel komunal.
- Kërkesave të administratës së shkollave.

Seksioni për arsim

Saubi Avziu,

_____.

Lazim Idrizi,

_____.